

RREGULLORE
MBI PROCEDURËN E DHËNIES SË
DEKORATAVE DHE TITUJVE TË NDERIT
NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 4 të ligjit nr. 8113, datë 28.03.1996 “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”, Presidenti i Republikës nxjerr këtë rregullore në të cilën përcaktohen rregullat e procedurat për dhënien e tyre.

1.

Sipas ligjit nr. 8113, të vitit 1996 dhe shtesave e ndryshimeve të tij me ligjin nr. 8765, dt. 02.04.2001; ligjin nr. 8971, dt. 14.11.2002, në Republikën e Shqipërisë jepen këto dekorata:

- **Urdhri i Flamurit Kombëtar**
- **Urdhri “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”**
- **Urdhri “Nderi i Kombit”**
- **Urdhri “Mjeshtër i Madh”**
- **Urdhri “Nënë Tereza”**
- **Urdhri “Naim Frashëri”**
- **“Medalja e Artë e Shqiponjës”**
- **Medalja “Martir i Demokracisë”**
- **Medalja “Pishtar i Demokracisë”**
- **Medalja “Për Shërbime Ushtarake”**
- **Medalja “Për Merita të Veçanta Civile”**
- **“Medalja e Mirënjohjes”**

2.

Dhënia e dekoratave është kompetencë e Presidentit të Republikës, e përcaktuar në Kushtetutë, nenet 92, pika “ç” dhe 93. Vetë dekorimi nuk është një e drejtë dhe nuk mund të kërkohet si e tillë, në rrugë individuale apo institucionale.

3.

Dekoratat u jepen individëve dhe personave juridikë, në përshtatje me kontributet dhe vlerat, rolin dhe ndikimin e tyre në opinionin publik.

4.

Presidenti i Republikës ka të drejtë të japë dekoratë me iniciativën e tij. Si rregull, Ai e përdor këtë iniciativë për promovimin e vlerave të personaliteteve zyrtare e publike që luajnë rol të rëndësishëm me aktivitetin e tyre në zhvillimin e vendit. (Shih Aneksin 1)

5.

Si rregull, të drejtën për të paraqitur propozim për dekorim para Presidentit të Republikës e kanë titullarë të institucioneve zyrtare e publike, të cilët, synojnë të evidentojnë e nxisin kontribute e vlera të veçanta në dobi të shoqërisë si dhe për të vlerësuar e respektuar mbartësit e tyre (Shih Aneksin 2)

6.

Të gjitha propozimet që plotësojnë kriteret për të cilat bëhet fjalë në pikat 3, 9, 10 (a, b, c, d) të kësaj rregulloreje, shqyrtohen nga një komision/bord konsultativ, i cili jep sugjerimet përkatëse për çdo propozim të paraqitur, përpara se t'i kalojnë Presidentit të Republikës.

7.

Parlamentarët, anëtarët e gjykatave, punonjës të institucioneve zyrtare e publike, në qendër e në bazë, propozohen për dekorim nga drejtuesit e institucioneve të tyre. (Sipas listës së paraqitur në Aneksin 2).

8.

Shtetasit e huaj që ndodhen në shërbim të institucioneve shtetërore shqiptare propozohen për dekorim nga autoriteti respektiv i institucionit ku janë atashuar. Për shqiptarët jashtë atdheut dhe personalitete të huaja që kanë dhënë apo japin ndihmë për Shqipërinë dhe imazhin e saj propozimin për dekorim e bën Këshilli i Ministrave, Kryeministri dhe Ministri i Jashtëm.

9.

Të propozuarit për dekorim, individë apo institucione, në përputhje me urdhërin/medaljen e propozuar, duhet të kenë arritje, kontribute dhe vlera të veçanta në shërbim të shoqërisë, të shtetit e të kombit.

- a. Propozimi bëhet duke mbajtur parasysh meritat e individit apo institucionit në përputhje me ligjin “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”, që ato të jenë në përshtatje me llojin e dekoratës, vlerat e ndikimin e saj në opinionin publik
- b. E njëjta dekoratë nuk mund të jepet dy herë.
- c. Nuk mund të jepet dekoratë më e ulët nga një dekoratë më e lartë e dhënë më parë
- d. Propozime nuk mund të bëhen për ata persona që janë të dënuar për shkelje të rënda të ligjit ose janë në hetim.
- e. Procesi i shqyrtimit të propozimit apo momenti i dorëzimit të dekoratës mund të shtyhet apo pezullohet përkohësisht për rrethana të paparashikuara, që dëmtojnë reputacionin dhe vlerën e aktit të dekorimit në opinionin publik, deri në sqarimin e këtyre rrethanave.

10.

Propozimi për dekorim është i plotë dhe shqyrtohet në kohën e duhur kur plotëson kriteret e mëposhtëme:

- a) Dërgohet rreth dy muaj para veprimtarisë, përvjetorit apo ngjarjes historike që i përket individit apo institucionit;
- b) Kur propozimi për dekorim firmoset nga titullari i institucionit që ka të drejtën e propozimit;
- c) Shoqërohet me relacionin përkatës ku paraqiten arritjet dhe meritat e veçanta të propozuarit;
- d) CV-ja e personit dhe arsyetimi rreth motivacionit;

11.

Praktika dhe procedurat e Rregullores së Dekorimeve hartohen dhe ndiqen nga Drejtoria Juridike, në përbërje të së cilës është Zyra e Dekorimeve.

- a) Të gjitha propozimet, nëpërmjet protokollit, kalojnë tek Sekretari i Përgjithshëm, i cili ia kalon për procedurë Drejtorisë Juridike.

- b) Zyra e Dekorimeve e Drejtorisë Juridike verifikon nëse materialet e propozimit janë të plota sipas kërkesave procedurale. Nëse materiali nuk është i plotë, kërkon me shkrim, brenda 15 ditëve nga marrja e propozimit nga institucioni propozues të bëjë plotësimin. Riparaqitja e plotësimit bëhet jo më vonë se 15 ditë nga marrja e njoftimit.
- c) Nëse materiali për dekorim është i plotë, Zyra e Dekorimeve bën paraqitjen e propozimit për dekorim, nëpërmjet Drejtorit të Drejtorisë Juridike, tek Sekretari i Përgjithshëm, i cili pas shqyrtimit nga komisioni/bordi konsultativ, i kalon tek Presidenti i Republikës.
- d) Kur propozimi miratohet nga Presidenti i Republikës, Zyra e Dekorimeve përgatit dekretin dhe çertifikatën.
- e) Pas firmosjes së dekretit dhe çertifikatës nga Presidenti i Republikës, Zyra e Dekorimeve nëpërmjet Drejtorit të Drejtorisë Juridike, njofton institucionin propozues për miratimin e propozimit dhe kërkon njoftimin për organizimin e ceremonisë për dhënien e dekoratës, programin, kohën dhe vendin ku do të zhvillohet ceremonia.
- f) Nëse dekorata nuk tërhiqet nga institucioni 60 ditë pas njoftimit nga Drejtoria Juridike, dhënia e saj mund të pezullohet.
- g) Procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e një dekorimi zgjasin jo më pak se dy deri tre muaj.
- h) Kur propozimi për dekorim nuk miratohet, Zyra e Dekorimeve, nëpërmjet Drejtorit të Drejtorisë Juridike, i bën njoftimin institucionit propozues për mosmiratimin.
- i) Zyra e Dekorimeve përgatit dekoratën dhe bën regjistrimin e dekorimit në librin e regjistrimit dhe në kartotekë. Dekreti për dekorim publikohet në Website-in Zyrtar të Presidentit të Republikës.
- j) Praktikat e përfunduara arkivohen.

12.

Ceremonia e dhënies së dekoratës organizohet nga institucioni që ka propozuar dekorimin në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike.

- a) Dhënia e dekoratave është e lidhur me përvjetorë e ngjarje të rëndësishme historike e aktuale, festat kombëtare, por jo domosdo e lidhur me to.
- b) Dhënia e dekoratave bëhet me ceremoni pubike / jopublike.
- c) Institucioni propozues informon Drejtorinë Juridike ose drejtpërdrejt Sekretarin e Përgjithshëm për mënyrën e organizimit të ceremonisë.
- d) Dekoratën e jep Presidenti i Republikës, ose persona të deleguar personalisht nga Ai.

- e) Në raste të veçanta, për personalitete me merita shumë të spikatura, ceremonia e dekorimit organizohet në selinë e Presidentit, ku Presidenti i Republikës e jep vetë dekoratën.
- f) Dekorata i jepet personit që dekorohet. Nëse dekorimi është pas vdekjes dekorata i jepet familjarëve të personit të dekoruar.
- g) Çertifikata përmban emrin e të dekoruarit, dekoratën e dhënë, motivacionin e personalizuar, numrin e dekretit të Presidentit, firmoset nga Presidenti i Republikës dhe vuloset me vulën e Presidentit.

13.

Përveç dekoratave, në mbështetje të nenit 92, pika ç, e Kushtetutës së Shqipërisë, Presidenti i Republikës jep edhe **Tituj Nderi**.

14.

Për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj Rregulloreje ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Presidentit dhe Drejtoria Juridike.

PRESIDENTI

ALFRED MOISIU

Aneks 1.

Presidenti i Republikës merr inisiativën për dekorim për:

- Kryetarin e Kuvendit;
- Kryetarin e Këshillit të Ministrave;
- Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese;
- Kryetarin e Gjykatës së Lartë;
- Prokurorin e Përgjithshëm
- Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit
- Ministrin
- Shefin e Shtabit të Përgjithshëm;
- Drejtorin e Shërbimit Informativ Shtetëror;
- Drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë;
- Gjeneralë;
- Bashkëpunëtorë të stafit të tij;
- Personalitete nga fusha të ndryshme të jetës, shoqërisë civile, etj;
- Shtetas të huaj që kanë merita në ndihmë të zhvillimit dhe prosperitetit të Shqipërisë dhe Kombit Shqiptar.

Aneksi 2.

Sipas pikës 5 të kësaj rregulloreje, të drejtën për të paraqitur propozime për dekorime e kanë:

- Kryetari i Kuvendit;
- Kryetari i Këshillit të Ministrave;
- Ministri;
- Kryetari i Gjykatës Kushtetuese;
- Kryetari i Gjykatës Lartë;
- Prokurori i Përgjithshëm;
- Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit;
- Shefi i Shtabit të Përgjithshëm;
- Drejtori i Shërbimit Informativ Shtetëror;
- Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë;
- Kryetari i Bashkisë;
- Kryetari i Akademisë së Shkencave;
- Kryetari i Konferencës së Rektorëve;
- Avokati i Popullit;
- Kryetari i Komitetit Kombëtar të Veteranëve.

